



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

Librazhd më ___/___/2023

P/VENDIM

NR _____ DT ___/___/2023

“ PER MIRATIMIN E KALENDARIT TE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2025-2027 DHE VITIT BUXHETOR 2025”

Mbështetur në ligjin nr.9936,datë 26.06.2008”Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë“,neni 24,i ndryshuar,ligjit nr.139/2015,datë 17.12.2015”Për Vetqeverisjen Vendore”, neni 41 ,ligjin nr. 68/2017 “ Për financat e vetqeverisjes Vendore “,si dhe në udhezimin numër 2 datë 06.02.2012 “ Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit,të ndryshuar,udhëzimin nr 23,datë 30.07.2018,”Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetqeverisjes Vendore.”Këshilli i Bashkise i mbledhur sot më datë ___/___/2023 me propozim të Kryetarit të bashkisë Librazhd :

VENDOSI :

1. Të miratoj kalendarin e programit Buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025 sipas tabelës dhe relacionit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISE
MARIGLEN DISHA

PERSONI PERGJEGJES

Brenda muajt dhjetor	Kryetari i NJQV-së	Përgatit dhe paraqet në Këshillin Bashkiak Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm
Deri - 31 dhjetor	Këshilli i Njesisë Vendore	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm
15 janar	Kryetari i NJQV-së	Kryetari shpërmdan kalendarin e programit buxhetor afatmesëm tek të gjitha njësitë shpenzuese
31 Janar	Kryetari i NJQV-së	Kryetari i njesisë paraqet për shqyrtim dhe miratim raportin e vlersimit të ardhurave dhe shpenzimeve
1 mars	Këshilli i Njesisë Vendore	Miraton raportin e vlersimit të të ardhurave dhe shpenzimeve
Brenda dates 15mars	Kryetari i NJQV-së	Paraqet për miratim në Këshillin e NJQV-së tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA
15 mars	Këshilli i Njesisë Vendore	Miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm
20 mars	Kryetari i NJQV-së	Miraton udhezimin e përgatitjes së buxhetit të njesisë vendore dhe e shpermdan tek EMP
21 Mars -25 Prill	DEMP	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
26 Prill - 27 Prill	Njësia e vetëqeverisjes vendore	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për PBA 2025-2027
28 Prill - 30 Prill	DEMP	Njesisë shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat e përgatitura
1 Maj - 15 Maj	GMS	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
16 Maj - 26 Maj	Kryetari i NJQV-së	Organizon seancat dëgjimore me Banorët
27 Maj - 29 Maj	Kryetari i NJQV-së	Prezanton dokumentin e PBA 2025-2027 me shoqërinë civile
30 Maj - 31 Maj	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Perpilon draftin e fazes së parë të PBA-së 2025-2027
1 Qershor	Kryetari i NJQV-së	Dërgon pranë Ministrisë së Financave projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Deri - 20 Qershor	Ministria e Financave	Dwrgon komente një raport me mendime mbi projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Deri -25Qershor	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Reflekton komentet e Ministrisë së Financave
Deri - 30Korrik	Këshilli i Njesisë Vendore	Shqyrton dhe miraton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm
Deri - 5 Korrik	Kryetari i NJQV-së	Merr masat për publikimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm
Deri - 20 Korrik	Këshilli i Njesisë Vendore	Miraton tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm
25Korrik	Kryetari i NJQV-së	Miraton udhezimin përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm
26 Korrik-31 Gusht	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	shpërmdan tek njesisë
1 Shtator	DEMP	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare.
2 Shtator - 14 Shtator	GMS	EMP paraqesin në bashki kërkesat buxhetoretë rishikuara
Deri - 15	Kryetari i NJQV-së	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Deri 5 Tetor	Ministria e Financave	Dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar
Deri - 20 Tetor	Ministria e Financave	Organizohen seanca konsultimi me njwsitw e vetqeveritjes vendore
6 Tetor -30 Nentor	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Sipas rastit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të PBA
25 Dhjetor	Këshilli i njesisë vendore	Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2025 si dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2025-2027 dhe i paraqet për shqyrtim në Këshill.
	Kryetari i NJQV-së	Miraton programin buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe buxhetin vjetor
		Merr masat për publikimin dokumentin e plotë të programit buxhetor afatmesëm

HARTOI KALENDARIN
DREJTORI I BUXHETIT

Aferdita Alla



MIRATOI

KRYETARI I BASHKISE

MARIGLEBN DËSHA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

P/ VENDIM

NR ___ DATE ___/12.2023

“PER NJE NDRYSHIM NE VKB NR. 107 ,DATE 28.12.2022 ”PER MIRATIMIN E
BUXHETIT TE VITIT 2023 TE BASHKISE LIBRAZHD DHE PROGRAMIT
PERFUNDIMTAR BUXHETOR AFATMESEM 2023-2025 ”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Date 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore , te Ligjit Nr.9936 Date 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ , i ndryshuar në Ligjin Nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si dhe në Udhezimin nr. 23 ,datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore” , Udhezimi nr.2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë ___/12/2023 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI :

1. Të miratojë pakësim te burimit financiare per vitin 2023 të bashkisë Librazhd në vlerën 500,000 lekë sipas v.k.b nr.107dt.30.11.2023”Rritje e pakesim plani buxhetor te vitit 2023 te te ardhurave vendore”.
2. Të miratojë pakesim fondi në zërin shpenzime operative per drejtorine e pyjeve në vlerën 500,000 lekë në strukturën buxhetore si më poshtë:

- Pakesim fondishpenzime operative drejtoria e pyjeve :

Kodi i institucionit	Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera ne leke
128 001	00	4260	0 5	602	500,000 lekë

3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISE
Mariglen Disha

Ndërtim me element parafabrikat te godines se Nj Adm Polts	0.0	0.1110	0.5	231	5,500,000																2,769,551	2,730,449	
Rikonstrukcion kanali Rroci Nj Adm Hoxhishit kanali Orenje Fitoq, kanali Letem (Geshenje me varzhim), kanali kultives Studen	0.0	0.4240	0.5	231	8,170,549	8,170,549																	
Totali Investimeve					98,573,015	11,752,000																	
Shpenzimet ne Total nga te ardhurat					166,361,000	12,202,000	12,202,000	12,202,000	14,231,000	14,231,000	14,231,000	14,231,000	14,231,000	13,731,000	14,231,000	14,231,000	14,231,000	14,231,000	14,231,000	14,235,000	14,293,000	14,312,000	

D/Buxheti dhe Menaxhimit Financar
Aterdita ALLA

Kryetari i Bashkise
Margjen DISHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

PROJEKT-VENDIM

Nr _____ Datë ____ / ____ /2023

Për miratimin e kontratës së **“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të Bashkisë Librazhd”** në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit midis Bashkisë Librazhd dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2023, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit , bazuar në:

Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 8, 9, 54 të tij;

Ligjin Nr.10463 datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar;

Ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenet 9 e 11;

Vendosi

1. Të miratojë lidhjen e kontratës së **“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të Bashkisë Librazhd ”**, në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit midis Bashkisë Librazhd dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.,sipas draftit bashkangjitur.
2. Ngarkohen Kryetari dhe Administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi : Sekretar i Përgjithshëm
Bajram Pishkashi

KRYETAR I BASHKISË
MARIGLEN DISHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

Nr. _____ Prot

Librazhd më / / 2023

Relacion

Mbi miratimin e kontratës së **“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të Bashkisë Librazhd”** në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasan midis Bashkisë Librazhd dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. midis Bashkisë Librazhd dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.

**Këshillit Bashkiak
Ketu**

Siç jeni në dijeni, shoqëria “ECO-ELB” sh.a. është krijuar si shoqëri publike me kapital të përbashkët të të gjithë bashkive të Qarkut Elbasan, dhe ka si objekt trajtimin dhe përpunimin e mbetjeve urbane në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit” Pas vendimin nr. 484, datë 13.12.2021 të Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për vendosje të sekuestros konservative për shoqërinë “Albtek Energy” sh.p.k., ky impjant është vënë në administrim të Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, deri në përfundimin e procesit dhe marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata. Me kontratën e qirasë nr. 548, datë 21.02.2022, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, i ka dhënë shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., kundrejt qirasë prej 1 (një) Euro në muaj (bruto), Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit” në tërësinë e tij, me qëllim vënien në funksion dhe përpunimin e mbetjeve urbane të të shtatë bashkive të Qarkut Elbasan.

Në këto kushte, bazuar në nenet 9 e 11 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, secila nga bashkitë e Qarkut, përfshirë edhe Bashkinë Librazhd, do të lidhin me shoqërinë publike “ECO-ELB” sh.a., **kontratën e “Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të Bashkisë Librazhd”** në mënyrë të drejtëpërdrejtë.

Kjo kontratë rregullon modalitetet e pranimit, trajtimit dhe përpunimit të mbetjeve, tarifën e përpunimit për ton e cila është përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme në vendim dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e paleve në lidhje me këtë proces.

Për sa mësipër, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 22 e 54 të tij, ju propozojmë miratimin e draft-kontratës bashkangjitur këtij relacioni.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj!

Konceptoi : Sekretar i Përgjithshëm
Bajram Pishkashi

Adresa: Sheshi “Gjorg Golemi”

Email: info@bashkialibrazhd.gov.al

www.bashkialibrazhd.gov.al

Sup. Pastrimit



842/1
DT 15.12.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "ECO - ELB" SH.A.

Nr. 807 Prot.

Elbasan, më 14.12.2023

Lënda: Dërgim informacioni

Drejtur: Bashkisë Librazhd

Në kuadër të kontratës së shërbimit Publik për Pranimin, Depozitimin dhe Trajtimin e mbetjeve, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe shoqërisë Kontraktuese "Eco-Elb" sh.a, me Nr. 842 Prot. datë 14.02.2023, të protokolluar me tonën me Nr. 105 më datë 14.02.2023, ju njoftojmë se afati i përfundimit të kësaj kontrate është data 31.12.2023.

Ju lutemi, nga ana juaj të bëhet e qartë kërkesa për rinovimin e kësaj kontrate, duke patur parasysh objektin që kjo kontratë ka: pranimin, depozitimin (grumbullimin) dhe trajtimin e mbetjeve urbane, duke theksuar që pas përfundimit të kontratës, pranë Impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane nuk do të bëhet pranimi i mbetjeve nga vetë Bashkia apo operatori ekonomik, i kontraktuar nga Bashkia për pastrimin e grumbullimin e mbetjeve të Bashkisë Librazhd.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

ADMINISTRATOR

Leli Kaja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

P/V E N D I M

Nr. ____, datë _____.____.2023

**PËR NDËRMARRJEN E NISMËS PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË
PLANIFIKIMIT**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015“Per veteqeverisjen Vendore” të ndryshuar, Neni 54,, Ligjin nr.107, datë 31.07.2024 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar, VKM nr.686, datë 22.11.2027 “ Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, vendimin nr.10, datë 08.02.207 të KKT-së “Miratimin e planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Librazhd” bazuar në kompetencat ligjore dhe funksionet dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e dates _____.____.2023 të :

VENDOSI:

1. Ndërmarrjen e nismës për rishikimin e Dokumentit të Planifikimit me hapat e procedurës së thjeshtuar;
2. Të ndiqen hapat e procedurës së thjeshtuar për rishikimin e Dokumentit të Planifikimit;
3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkise, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Librazhd;
4. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) dite pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË
MARIGLEN DISHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD

PROJEKT-VENDIM

Nr ____ Datë ____ . ____ .2023

Për transferimin e pasurive shtetërore në pronësi të Bashkisë Librazhd

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin Nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë Librazhd pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe relacionin bashkëngjitur këtij projekt-vendimi, në mbledhjen e datës ____ / ____ / 2023.

VENDOSI:

1. Të miratoje kërkesën e Bashkisë Librazhd për transferimin e pasurive me status “SHTET” të paraqitura në tabelën sipas Shtojcës 1 bashkëlidhur vendimit, nga pronësia “SHTET” në pronësi të Bashkisë Librazhd.
2. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Projekteve dhe Investimeve, Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Ujitjes, Kullimit dhe Mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË

MARIGLEN DISHA

Shtojca 1

Nr	NR_PASURISE	PRONARI	Zona Kadastrale	Siperfaqet
1	410	Shtet	1517	838.2751471
2	447	Shtet	1517	35256.40481
3	419/4	Shtet	1517	3224.419341
4	419/6	Shtet	1517	12327.47322
5	446/3	Shtet	1517	40180.43854
6	419/3	Shtet	1517	6823.935064
7	419/1	Shtet	1517	7683.69463
8	419/2	Shtet	1517	6872.528105
9	414	Shtet	1517	2376.204451
10	413	Shtet	1517	1987.626484
11	419/10	Shtet	1517	19522.70697
12	419/9	Shtet	1517	2146.84347
13	419/8	Shtet	1517	6386.664889
14	412	Shtet	1517	46450.52857
15	417	Shtet	1517	2720.093414
16	418	Shtet	1517	11308.96392
17	416	Shtet	1517	5724.86759
18	546	Shtet	1517	72087.7057
19	311/2	Shtet	1517	4400.032295
20	310	Shtet	1517	10161.58372
21	342	Shtet	1517	9617.401758
22	343	Shtet	1517	8307.817009
23	307/2	Shtet	1517	16722.14904
24	307/1	Shtet	1517	4248.036548
25	341/3	Shtet	1517	21558.21307
26	312	Shtet	1517	19727.41821
27	309	Shtet	1517	6536.542579
28	308/15	Shtet	1517	975.9353114
29	308/6	Shtet	1517	1016.705393
30	308/7	Shtet	1517	1070.960463
31	306	Shtet	1517	15334.04261
32	282	Shtet	1517	30623.2256

Të_dhëna_pasuritë.xls



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ dt. ____ . ____ .2023

**“MBI NDARJEN E BURSAVE PËR NXËNËSIT E VITEVE TË PARA TË ARSIMIT
PROFESIONAL PER VITIN SHKOLLOR 2023-2024”**

Mbështetur në Ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetë qeverisjen vendore” nenin 30 ‘Funksionet dhe kompetencat e deleguara’, nenin 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, në V.K.M. nr. 666dt.10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe percaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënës të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2023-2024” si dhe në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 6470/87 Prot. dt. 20/11/2023 “Dërgohet plani i shpërndarjes së bursave për nxënës të ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mesimor 2023-2024”. I propozoj Këshillit Bashkiak në mbledhjen e tij të radhës të

VENDOSI:

I. Të miratojë burse të plotë për nxënës sipas listës së mëposhtme:

1. Adrian Hekura Shuli: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “B.Çela”Durrës, Dega “Elektroteknike”
2. Florjan Guri Shuli: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “B. Çela”Durrës, Dega “Elektrotermike”
3. Klajdi Niko Kokoli: Nxënës në Shollën e Mesme Profesionale “B. Çela”Durrës, Dega “SHMT”
4. Klajdi Zydi Xhepi: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega Elektroteknike.
5. Aldi Ylli Brahja: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega “SHMT”
6. Aleks Eduart Methasa: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega “SHMT”
7. Fabjan Eduart Methasa: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega “SHMT”
8. Mirkelen Vasil Alla: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega “:Termohidraulike.”
9. Leo Andon Kodraliu: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “B. Çela”Durrës, Dega “Elektroteknike.”
10. Roland Kimet Murati: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega “SHMT”

11. Leo Shpëtim Lleshi: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega “Elektrike”
12. Lorenc Afrim Mona: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “B. Çela”Durrës. Dega”Elektroteknike.”
13. Ertugel Gëzim Terziu: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan. Dega”Elektroteknike.”
14. Xhesjan Rexhap Hala: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Karl Gega”Tiranë. Dega”Ndërtim.”
15. Enis Shpëtim Poçi: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega “:Mekanike.”
16. Arjan Çelik Alia: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega “Hoteleri-Turizëm.”
17. Ergis Behar Bardhi: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “B.Çela”Durrës, Dega” Elektroteknike”
18. Jasin Nebi Bajrami: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Gjergj Canco”Tiranë. Dega”Elektroteknike.”
19. Artur Kristo Beti: Nxënës në Shkollën Teknike Profesionale “Kolë Margjini”Shkodër. Dega”Pyje”.
20. Ardit Mehmet Xhepi: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan. Dega”Elektroteknike.”
21. Mikel Ramazan Sejдини: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “B.Çela”Durrës, Dega ” Elektroteknike”
22. Zenel Spiro Tota: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega “SHMT”
23. Servet Xhevahir Bici: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega “TIK”
24. Armando Bujar Hoxha: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Karl Gega”Tiranë. Dega”Ndërtim.”
25. Anita Eduart Muraçi: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega “TIK”
26. Brajan Kosta Gjura: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega “Elektroteknike”

II. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Turizmit si edhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, Bashkia Librazhd.

III. Ky vendim hyn ne fuqi dhjete dite pas shpalljes se tij.

KRYETARI BASHKISE

Mariglen DISHA

RELACION

PER

NDARJEN E BURSAVE PER NXENESIT E VITEVE TE PARA ,VITI SHKOLLOR

2023-2024

KESHILLI BASHKIAK

Mbështetur në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me numer 6470\87 prot date 20\11\2023 ardhur tek ne me nr 7326 prot date 21/11/2023 ku Bashkise Librazhd i jane akorduar 43 Bursa per klasën e 10 (vitin e parë),në shkollat e mesme të arsimit profesional.

Kërkesat për bursa që kanë aplikuar në bashkinë Librazhd janë 26. Nga këto 14 familje trajtohen me ndihmë ekonomike , 1 familje me pagë minimale +Kemp, 1 familje me ndihmë ekonomike + pension pleqërie, 6 familje me page minimale, 2 familje ndihmë ekonomike+ Kemp,1 familje me ndihmë ekonomike+Kemp+pension dhe 1 familje me pension Invaliditeti +Kemp.

Sipas Shkollave profesionale vijojne si me poshte:

1	Shkolla Profesionale Elbasan	15 nxënës
2	Shkolla "Gjergj Canco" Tirane	1 nxënës
3	Shkolla " Karl Gega" Tirane	2 nxënës
4	Shkolla "Beqir Çela" Durrës	7 nxënës
5	Shkolla "Kolë Mërgjini"Shkodër	1 nxënës

Sipas kriteteve te percaktuara ne VKM 666 date 10/10/2019 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike,për vitin shkollor 2023-2024",në VKM Vendim nr. 854, datë 24.12.2019"Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 666 date 10/10/2019 të Këshillit të Ministrave 2019 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike"i ndryshuar,të gjithë aplikuesit përfitojnë bursa.

Punoi:V.Gega





7326
Dt. 31.11.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 470/87 Prot.

Tiranë, më 20.11.2023

Lënda: Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit që cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2023-2024.

Drejtuar; Bashkisë Librazhd,
Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar _____,

Të nderuar znj/z.

Në zbatim të Vendimit nr.666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", të ndryshuar, Ministria e Arsimit dhe Sportit, me qëllim që çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim arsimi bazë për nxënësit që ndjekin mësimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, që plotësojnë kriteret sa vijon janë parashikuar bursa ushqimore/financiare.

Kriteri ekonomik: a) nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët ndjekin procesin mësimor në largësinë mbi 5km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe që akomodohen në konvikte publike; b) nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9- vjeçare brenda rrezes prej 5 km, të cilët plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr.1, që akomodohen në konvikte publike, c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.

Kriteri joekonomik: a) nxënësit, të cilët kanë përfituar statusin e jetimit; b) nxënësit, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë; c) nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe nxënësit me aftësi të kufizuara, të vërtetyar nga komisioni mjekoligjor; ç) nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë; d) nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit; e) nxënësit, të cilët janë identifikuar dhe trajtuar si viktimat e trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror; ë) nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës; g) Nxënësit me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton.

Ndaj sa më sipër, mbështetur në kërkesën tuaj për numrin e nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë në institucionet arsimore publike dhe që parashikohet të përfitojnë bursa/ kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, ju dërgojmë numrin bursave të miratuara, për vitin shkollor 2023-2024,

43 (dyzetë e tre) bursa.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por që në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë dhe për uljen e braktisjes shkollë të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen TOLA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

PROJEKT-VENDIM

NR _____, Date __/12/2023

“PER MIRATIMIN E LISTES TE FAMILJEVE QE PLOTESOJNE KUSHTET PER PROGRAMIN E KOMPENSIMIT TE QIRASE”

Duke u mbështetur në Ligjin Nr 22/2018 “Për Strehimin Social”, Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 pika 2 dhe neni 9 pika 1.1 b dhe neni 24 pika 2, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” dhe në VKM Nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qerasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”. I propozoj Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës 29/12/2023

TE VENDOSI:

- I. Të miratojë në parim listën sipas pikëzimit për 61 familje që do të përfitojnë nga programi i subvencionimit të bonusit të qirasë dhe aplikantët në liste pritje.
- II. Miratimin e subvencionimit të qirasë për periudhën Janar-Dhjetor 2024 për tu financuar në masën 75% nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë dhe 25 % nga Bashkia Librazhd.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi të ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorial (Zyra e Sherbimeve dhe Strehimit) si dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Planifikimit Financiar.
- IV. Vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes

KRYETARI BASHKISE

Mariglen DISHA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

RELACION

Mbi dhënien e subvencionimit të qerasë në tregun e lirë

Duke u mbështetur në Ligjin Nr 22/2018 “Për Strehimin Social”, Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 pika 2 dhe neni 9 pika 1.1 b dhe neni 24 pika 2, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore” dhe në VKM Nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qerasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Strehimit dhe Sherbimeve mori në shqyrtim kërkesën e 126 personave.

Fillimisht është bërë shqyrtimi i dokumentacionit për secilin aplikant. Në vijimësi u hartua lista dhe në bazë të sistemit të miratuar të pikëzimit u bë renditja e aplikantëve. Duke patur parasysh fondin në dispozicion, pikët për çdo familje dhe gjendjen social-ekonomike të tyre komisioni i strehimit vendosi të aprovoj listën të përbërë nga 61 aplikantë.

- I. Aplikantet fitues janë :
1. Shpresa Musa Dosku
2. Haziz Brasha
3. Rahman Petrit Hasgjeta
4. Liljana Lytfi Balla
5. Antoneta Ali Koci
6. Faik Qemal Balla
7. Elona Shefki Mojsja
8. Tafil Jonuz Seferi
9. Ramazan Hamit Kullolli
10. Fatmira Hysa
11. Nuriye Halil Lleshi
12. Xhevdet Kopaci
13. Taulant Fatmir Kurti
14. Istref Ozuni
15. Avni Murat Rruplli
16. Thelleza Zharri
17. Valbona Brasha
18. Rezarta Dilver Kushi
19. Gentila Doda
20. Jorgo Dilaver Kurti
21. Ramazan Isuf Brahja
22. Arjana Hysen Novaku
23. Rrushe Osman Hunci
24. Skender Shefqet Tanushi
25. Besnik Hekuran Kurti
26. Viturie Rexhep Doskja

27. Blerina Qamil Dobrenji
28. Ferdinand Petrit Kurti
29. Liljana Nuredin Brahja
30. Ali Gani Brahja
31. Nazife Bajram Xherri
32. Imer Korp Sula
33. Albina Kurti
34. Faik Kullafi
35. Adem Rruplli
36. Lulzime Tahiri (Roci)
37. Valentina Hoxha
38. Aferdita Vreto
39. Eliverda Balliu
40. Jonida Hunci
41. Makbule Brasha
42. Fatmir Kurti
43. Djana Belba
44. Eglantin Albajrami
45. Natsha Goli
46. Nadire Cepi
47. Donika Zogolli
48. Kasem Jugu
49. Elidjona Stafa
50. Luan Rruplli
51. Nurie Bozhiqi
52. Dritan Brahja
53. Bujar Bogdani
54. Piro Halili
55. Osman Cota
56. Hasan Shehu
57. Dilaver Koxha
58. Ardian Lleshi
59. Eduard Zylali
60. Xhemal Beneri
61. Qanije Xhelili

II. Pas shqyrtimit te cdo aplikimi dhe afatit qe u vendosem per dorezimin e dokumentacionit te nevojshem, aplikantet te cilet jane ne liste priteje jane :

1. Grigori Cani
2. Nazif Xhafer Hoxha
3. Harun Sali Doda
4. Irena Balazi
5. Bardhyl Faik Poci
6. Vule Kadri Topi
7. Sonila Njelina
8. Qamile Ardian Brahja
9. Kostandina Muraci
10. Taulant Dosku
11. Fatmira Skita
12. Shpetim Vreto
13. Enxhi Balla
14. Hekuran Hasani
15. Petrit Gjini
16. Alketa Cela
17. Harun Kurti

18. Bukurie Hoxha
19. Enver Bardhi
20. Valbona Dobra
21. Fadil Kaca
22. Ymer Daja
23. Pajtim Deda
24. Behar Muraci
25. Bletar Ozuni
26. Vaide Kampula
27. Yllka Nasufi
28. Xhevahir Karaj
29. Klodiana Balla
30. Rimi Duka
31. Xhevit Murati
32. Xhemal Cela
33. Ramadan Belba
34. Blertan Leka
35. Ylli Brahja
36. Altin Brahja
37. Bukurie Hoxha
38. Petrit Xhabli
39. Andri Kullafi

Nga ky program iu lind e drejta për të përfituar nga programi i subvencionimit të qerasë në tregun e lirë familje të cilat i përmbushin kriteret për tu kualifikuar, ku nga këto familje 16 janë me persona me aftësi të kufizuar, 17 janë familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë, 6 janë të moshuar, - janë viktimë të dhunës në familje, 10 janë aplikantë që i përkasin minoritetit rom dhe egjiptian dhe pjesa tjetër janë familje të cilat i përmbushin kriteret e dhënies së subvencionimit të qerasë në tregun e lirë.

Spektori i Strehimit

Konceptoi : Ani Teta

Pranoi: Dorian Hasula



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

Librazhd me ___/___/2023

P/VENDIM

NR _____ DT ___/___/2023

MBI TRASFERIMIN KAPITAL PA PAGESE TE OBJEKTIT: "NDERTIM UJSJELLES I FSHATIT POLIS GOSTIME ,NJESIA ADMINISTRATIVE POLIS ,BASHKIA LIBRAZHD".

Mbështetur në ligjin nr.139/2015,datë 17.12.2015" Për Vetqeverisjen Vendore", neni 41 ,ligjin nr.10296 ,datë 10.07.2010" Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin", i ndryshuar ,udhëzimin nr.30,datë 27.12.2011," Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik " ,paragrafi 108,pika a,ligjin nr 68/2017 " Për financat e vetqeverisjes Vendore " ,në manualin për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e miratuar me Urdhër nr.9880,datë 15.07.2010" të Ministrit të Financave, ligjin nr 9228,datë 29.04.2004,I ndryshuar " Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare,i ndryshuar ."Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot me datë ___/___/2023 me propozim të Kryetarit të bashkisë Librazhd :

VENDOSI :

1. Te miratojë transferimin kapital pa pagese Ujsjelles Kanalizime Rajoni Elbasan.

Objektin:

- "Ndertim Ujsjellesi i Fshatit Polis Gostime ,Njesia Administrative Polis ,Bashkia Librazhd", me vlerë 77,707,386 leke sipas situacionit perfundimtar dhe akt – kolaudimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit Territorial,Spektori i Aseteve,Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Spektori i Financës, Ujsjellës Kanalizime Rajoni Elbasan.
 3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISE
MARIGLEN DISHA

Adresa: Sheshi " Gjorg Golemi" email: www.bashkialibrazhd.gov.al,

info@bashkialibrazhd.gov.

RELACION

Mbeshtetur në ligjin nr. 139/2015 për “Vetqeverisjen Vendore” në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorët Publikë, si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhër të Ministrisë së Financave nr.8980 datë 15.07.2010 si dhe në Ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare “ndryshuar me Ligjin nr.9477 datë 09.02.2006 ,si dhe në mbeshtetje të VKM nr 302 date 11.05.2022 Per politikat Kombetare per riorganizimin e sektorit te furnizimit me uje dhe te largimit trajtimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura si dhe mbi marrveshjen e lidhur te dates 22.07.2022 per krijimin e SPK(subject I kompetencave te perbashketa) VKB NR __/__/2022

Te miratoje transferimin capital pa pagese Shoqerise Rajonale Ujsjelles Kanalizime Elbasan sha

Objektin Ndertim ujsjellesi fshati Polis Gostime njesia ad Polis Bashkia librazhd me vlere 77,707,386 leke

Ne baze te marrveshjes MIE ka 51 % te aksioneve, Bashkia Librazhd 3.13% te aksioneve, Bashkia Gramsh 4.13%, Bashkia Elbasan 28.52%, Bashkia Cerrik 5.46%, Bashkia Belsh 4.42%, Bashkia Peqin 3.34%, marrveshja eshte me nje afat 10 vjecar.

P/SEKTORI
P/ASETEKUF Dorian Hasulaj





MARRËVESHJE PËR KRIJIMIN E SUBJEKTIT TË KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE

Kjo marrëveshje lidhet sot më datë 22.07.2022 ndërmjet:

- Bashkisë Elbasan, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja,
 - Bashkisë Librazhd, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Kastriot Gura,
 - Bashkisë Gramsh, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Klodian Tafa,
 - Bashkisë Cërrik, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Andis Salla,
 - Bashkisë Belsh, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Arif Tafani,
 - Bashkisë Peqin, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Lorene Tosku
- dhe

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (këtu e më poshtë referuar si MIE) përfaqësuar nga Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë Znj. Belinda Balluku, këtej e tutje referuar të gjitha si "Palët".

Meqënëse:

- Duke pasur parasysh reformën e ndërmarrë për përmirësimin e performancës së shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe të shërbimit të konsumatorëve;
- Duke qenë të ndërgjegjshëm për nevojën e përmirësimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe grumbullimin e trajtimin e ujërave të ndotura urbane;
- Duke marrë në konsideratë faktin që shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin vazhdojnë të kenë nevojë për mbështetjen e autoriteteve qendrore për përmirësimin e administrimit të aseteve të saj, shëndoshjen e gjendjes së saj financiare dhe sigurimin e burimeve të financimit për investimet e nevojshme në zonat e tyre të shërbimit;
- Në mbështetje të VKM Nr.302 datë 11.05.2022 që autorizon MIE për hyrjen në një marrëveshje specifike me Bashkitë Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin



për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të Bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin;

- Në mbështetje të Vendimit Nr. 78 datë 23.06.2022 të Këshillit Bashkiak Elbasan, Vendimit Nr. 58 datë 30.06.2022 të Këshillit Bashkiak Librazhd, Vendimit Nr. 46 datë 31.05.2022 të Këshillit Bashkiak Gramsh, Vendimit Nr. 46 datë 28.06.2022 të Këshillit Bashkiak Cërrik, Vendimit Nr. 15 datë 22.02.2022 të Këshillit Bashkiak Belsh dhe Vendimit Nr.5 datë 25.02.2022 të Këshillit Bashkiak Peqin që autorizojnë Kryetarët e Bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin të hyjnë në një marrëveshje specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të Bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin;

Palët bien dakort të hyjnë në një marrëveshje me kushtet dhe termat e mëposhtëm:

Neni 1

Baza Ligjore

1. Kjo marrëveshje lidhet në përputhje me:
 - a) Dispozitat e pikës 5 të nenit 14 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar;
 - b) Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar;
 - c) Ligjin Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”;
 - d) VKM Nr. 302 datë 11.05.2022, “Për politika kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

Neni 2

Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka si qëllim krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetës - Kanalizimeve (SKP-UK), i cili do të kryejë veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të Bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin të cilat janë palë e kësaj marrëveshjeje, pjesë e të cilës është edhe AKUM.

Neni 3

Forma dhe emri i Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta

1. Palët bien dakort që Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetllës Kanalizimeve do të jetë një shoqëri aksionare e krijuar SKP-UK, tek e cila do të transferohet tërësisht veprimtaria ekonomike e shoqërive ekzistuese të ujësjetllës-kanalizimeve të cilat aktualisht janë në pronësi të Bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin.
2. Emri i Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta i krijuar sipas kësaj marrëveshje do të jetë Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a.
- 3.
4. Shoqëria aksionare e krijuar sipas kësaj marrëveshje do të administrohet me dy nivele administrimi. Organet drejtuese të shoqërisë do të krijohen dhe kompozohen sipas dispozitave të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar.
5. Shoqëria do të ketë si statut të saj statutin tip të shoqërive të ujësjetllës-kanalizimeve të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

Objekti i SKPUK

1. Objekti i SKPUK-së është kryerja e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territoret administrative të Bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin në përputhje me legjislacionin e sektorit të furnizimit me ujë.
2. Shoqëria e re e krijuar mund të ngarkohet me detyrimin e mbledhjes së një ose më shumë taksave vendore për llogari të bashkive palë në këtë marrëveshje, nëse kjo kërkohet prej tyre.

Neni 5

Afati i SKPUK

Palët bien dakort që SKPUK i krijuar sipas kësaj marrëveshje të krijohet për një periudhe të pacaktuar.

Neni 6

Kontributi i Palëve

1. Kapitali fillestar për Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a që do të themelohet do të jetë në masën 10.000.000 Leke. Në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me qëllim

themelimin dhe regjistrimin e shoqërive të reja SKP-UK, MIE do të likujdojë vlerën e 51% të aksioneve që do të përfitojnë.

2. Pjesëmarrja në përqindje në asamblenë e akcionerëve në shoqërinë e re ujësjellës-kanalizime (SKPUK) e Bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin, në pronësi të cilave janë aktualisht shoqëritë ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, është përlllogaritur në përpjesëtim me numrin e abonentëve aktive që këto shoqëri kanë duke përfshirë edhe kontratat aktive aktuale që administrohen nga vetë Bashkitë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e SKPUK, vlera totale e të cilave do të përbejë 49% të aksioneve të shoqërisë së re dhe përbëhet në përqindje si vijon: Bashkia Elbasan 28.52%, Bashkia Librazhd 3.13%, Bashkia Gramsh 4.13%, Bashkia Cërrik 5.46%, Bashkia Belsh 4.42% dhe Bashkia Peqin 3.34%.
3. Pas themelimit të shoqërisë së re SKP-UK, Bashkitë Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin do të transferojnë tek SKP-UK të gjithë veprimtarinë e shoqërive të UK, që kryejnë aktualisht veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në territoret administrative respektive në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë".
4. Në Bashkitë Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin ku ka njësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, të cilat nuk kanë qenë të organizuara në formën e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, bashkia, brenda datës 31 dhjetor 2022, është përgjegjëse për inventarizimin fizik, vlerësimin dhe transferimin e këtyre njësive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e Shoqërisë Rajonale Ujësjelles Kanalizime Elbasan sh.a.
5. Pasi procesi i transferimit të ketë përfunduar, përcaktimi i vlerës nominale të 51% të aksioneve që do të zotërohen nga MIE, në Shoqërinë Rajonale UK Elbasan sh.a do të realizohet pasi vlera e saktë e aksioneve të përfituara të përcaktohen në bazë të raportit që do të hartohet nga ekspert i kontabël që do të caktohet gjatë procedurave të transferimit.
6. Akcioneret do të nënshkruajnë kontratë rritje kapitali që investimet e ardhshme dhe fitimi të kapitalizohen dhe të alokohen derisa të arrijnë përqindjen sipas kësaj marrëveshje.
7. Shlyerja e vlerës nominale të aksioneve që do të zotërohen nga MIE do të kryhet duke njohur investimet në proces të cilat janë financuar nga buxheti i shtetit dhe me anë të investimeve kapitale që qeveria do të ndërmarrë në vitet në vijim në Shoqërinë Rajonale UK Elbasan sh.a.
8. Në rastet kur vlera e investimit të parashikuar dhe marrë tashmë përsipër nga qeveria qendrore dhe të pasqyruar në tavanet buxhetore do të kalojë vlerën nominale të 51% të aksioneve, pasqyrimi i vlerës së tepriçës nuk ndryshon masën e pjesëmarrjes në aksione të Shoqërisë Rajonale UK Elbasan sh.a.
9. Gjithashtu, si instrument për shlyerjen e vlerës nominale të aksioneve që do të zotërohen nga MIE, do të konsiderohet edhe shuarja me kompensim e vlerës së detyrimeve që shoqëritë UK Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin kanë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e SKP-UK, ndaj institucioneve qendrore

buxhetore dhe jo buxhetore, deri në masën e pagimit të plotë të 51% të aksioneve të shoqërisë së re.

Neni 7 Procedurat e Transferimit

1. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive UK Elbasan sh.a, UK Librazhd sh.a, UK Gramsh sh.a, UK Cërrik sh.a, UK Belsh sh.a dhe UK Peqin sh.a me propozimin dhe mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), do të caktojnë ekspertë të pavarur për të vlerësuar dhe asistuar në mënyrë të përbashkët për të gjitha shoqëritë, gjatë procedurave të transferimit të veprimtarisë për tek shoqëria e re SKP-UK.
2. Bilanci i transferimit të konsiderohet bilanci i datës 31.12.2021.
3. Data e transferimit efektiv, në të cilën aktivitetet do të konsiderohen të kryera nga Shoqëria Rajonale UK Elbasan sh.a do të jetë dita e 45-të nga njoftimi i Drejtorive Tatimore.
4. Veprimtaritë e UK në periudhën nga data e bilancit të transferimit deri në datën e transferimit efektiv do të sjellë si pasojë ndryshimin e balancave të transferimit, të cilat do të rregullohen me efekt në tepricën e transferimit që do të njihet. Pasqyrat financiare do të hartohen në datën e transferimit efektiv dhe për këtë mund të përgatitet një raport i posaçëm për të identifikuar diferencat dhe rregullimin e tyre.
5. Të gjitha shpenzimet e nevojshme për kryerjen e procedurës së themelimit të Shoqërisë Rajonale UK Elbasan sh.a, shpenzimet e nevojshme për caktimin e eksperteve si dhe shpenzimeve të transferimit të plotë të veprimtarisë tek shoqëria e re SKP-UK do të përballohen nga buxheti i shtetit. Vlera e shpenzimeve të mësipërme si dhe vlera e shpenzimeve fillestare që do t'i akordohet shoqërisë Rajonale UK Elbasan sh.a do të përlllogaritet si kontribut në shlyerjen e vlerës nominale të aksioneve të përfuara nga MIE.
6. Shpenzimet për likuidimin e shoqërive transferuese do të përballohen nga shoqëria e re SKP-UK.

Neni 8 Prishja e marrëveshjes në mënyrë të njëanshme

1. Asnjë nga palët nuk mund të prishë këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme pa kaluar 10 vjet nga krijimi i SKPUK-së.
2. Pas kalimit të afatit 10-vjeçar të përcaktuar në pikën 1, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në çdo kohë mund të vendosë tërheqjen e njëanshme nga kjo marrëveshje duke i transferuar aksionet e saj në shoqërinë e krijuar sipas kësaj marrëveshje tek Bashkitë Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin proporcionalisht me përqindjen e aksioneve të tyre në shoqëri.
3. Nëse një nga Bashkitë Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin kërkon prishjen e njëanshme të kësaj marrëveshje pas kalimit të afatit 10-vjeçar, bashkia duhet të ndërmarrë

hapat e kërkuara në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar.

4. Nëse një nga bashkitë vendos të prishë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen, sipas pikës "3", ajo është e detyruar që për vitin buxhetor pasardhës të mbulojë të gjitha investimet apo detyrimet e tjera financiare përfshirë masat e miratuara në biznesplanin e shoqërisë së ujësjellës-kanalizimeve.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që do të lindë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, palët do të përpiqen ta zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërt secila nga palët mund t'i drejtohet për zgjidhjen e saj Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 10

Të tjera

Gjatë gjithë periudhës tranzitore të transferimit, Shoqëritë e Ujësjellës Kanalizimeve do të pezullojnë të gjitha planet e investimeve dhe procedurat e prokurimit që kanë aktualisht në proces, përveç mirëmbajtjeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi është nënshkruar rregullisht nga palët dhe është marrë shprehja e ligjshmërisë së marrëveshjes nga ana e Prefektit/Prefektëve sipas kërkesave të nenit 14 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar.

Kryetari i Bashkisë Abasjan

Arben Hoxha

Kryetari i Bashkisë Peqin

LORENÇ TOSKA

Kryetari i Bashkisë Librazhd

Ilir Ahmeti

Kryetari i Bashkisë Belsht

Arif Gëlleci

Kryetari i Bashkisë Gramsh

Mirëza Hoxha

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Kryetari i Bashkisë Cërrik

Andri Soli

Andri Soli

Andri Soli

Andri Soli

Andri Soli

Andri Soli

Andri Soli